



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.82/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në konfliktin administrativ të paditësit “...” B.I. me seli në Ferizaj, Rr. ‘’...’’, pn., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.H, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti – vlerësim tatimor, vlerë kontesti 585.45 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur me datë 10.10.2022, në prani të përfaqësuesit të palës paditëse K.H dhe përfaqësuesit të palës së paditur, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “A...” B.I. me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.H, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Vendimi nr. 599/2019 i datës 24.02.2020, i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e parashtruar në gjykatë, me datë 05.05.2020, dhe të plotësuar me parashtrësën e datës 13.10.2020, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës ATK, duke kërkuar anulimin e vendimit nr. 599/2019 i datës 24.02.2020, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike. Në seancë e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse ka deklaruar se: kundërshtojmë të hyrat në vlerë prej 5,278.86 €, të cilat janë trajtuar si të hyra me TVSH. Këto janë të hyra të cilat këtu

paditësi i ka inkasuar nga Kompania "A..." GMBH, e cila operon në Gjermani. Në këtë kompani paditësi ka realizuar Kontrata të Veçanta. Lidhur me këtë të hyrë kam konfirmim edhe prej Zyrës së Informimit të ATK-së se këto të hyra duhet të trajtohen pa TVSH. Jam dakord që paditësi në momentin që e ka arritur pragun prej 30,000.00 €, i njëjti duhet të regjistrohet si deklarues i TVSH-së, mirëpo prej të hyrave që i ka pasur në periudhën në Dhjetor 2016, shuma që e ka tejkaluar pragun është dashur që të trajtohet pa TVSH. Shpenzimet e procedurës i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 18.06.2021, kundërshton pretendimet e paditësit dhe konstaton se vendimi kontestues është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm, dhe i propozon gjykatës që të merr Aktgjykim me të cilin refuzohet në tersi si e pa bazuar kërkesëpapia e paditësit dhe të vërtetohet si i bazuar vendimi kontestues. Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se : shihet se ka edhe deponime të tjera të cilat e kanë mbishkrimin e transferit të njëjtë siç është ajo me datë 10.02.2016 në vlerën 2,000.79 €, me datë 07.04.2016 në vlerë 1,795.38 €, me 15.01.2016 në vlerë prej 5,101.29 € dhe katër vlera tjera, andaj, konsiderojmë se kemi pasur deponime të shumta, e jo vetëm një deponim siç pretendon pala paditëse për tejkalimin e pragut të TVSH-së. Lidhur me provën për të cilën pala paditëse deklarohet se ka marrë përgjigje nga ana e Zyrës së Informimit të ATK-së, e që realisht është një përgjigje e përgjithshme të cilën e ka bërë Departamenti për Regjistrim dhe Shërbim të Tatimpaguesve, është një përgjigje e cila është bazuar në pyetjen e paditësit, por që realisht nuk ka asnjë provë të cilën pala paditëse i ka bashkangjitur kësaj kërkesë për përgjigje, dhe po ashtu përgjigja është dhënë në formë të përgjithshme, dhe nëse i referohemi pjesës fundore të këtij e-maili paditësi për çdo paqartësi është ftuar edhe në Zyrën e Shërbimit të Tatimpaguesve në ATK. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik, ka administruar provat dhe atë: Vendimi Nr.599/19 i datës 24.02.2020, raporti i Kontrollit i datës 09.12.2019, njoftim për Rivlerësim për periudhën tatimore 12/2016, vendimi Nr.612/2019 i datës 11.12.2019, ankesa e ushtruar në ATK e datës 29.12.2019, e-maili i datës 23.12.2019, përgjigja në

Padi e datës 18.06.2021, fletë-Intervista e Zyrës Regjionale ATK – Ferizaj, (data e palexueshme), qarkullimi Bankar në RBKO për periudhën 01.01.2016 deri 15.11.2019, libri i shitjes për vitin 2016.

Gjykata, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga deklaratimet në padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklaratimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor Kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se i padituri ka ushtruar kontroll tek këtu paditësi dhe me datë 09.12.2019 ka përpiluar raportin e kontrollit, e i cili raport për periudhën e kontrollit 12/2016, për TVSH-ë ka konstatuar ndryshime. Tutje nuk është kontestues as fakti se këtu paditësi me datë 29.12.2019 ka ushtruar ankesë në ATK-ë ndaj raportit të kontrollit të datës 09.12.2019 e për të cilën ankesë këtu e paditura me datë 24.02.2020 ka sjell vendimin nr. 599/2019, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës, 05.05.2019, ka iniciuar konfliktin administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i librit të shitjes për vitin 2016, dhe qarkullimit të llogarisë bankare në RBKO për vitin 2016, Gjykata ka gjetur se subjekti tatimor këtu paditësi gjatë periudhës tatimore 01/2016 deri 12/2016, ka pasur shitje në vlerë prej 35,549.00 euro, dhe bazuar në dispozitën ligjore nga neni 6, i ligjit 05/L-037 për TVSH-ë i cili shprehimisht përcakton se nëse brenda vitit kalendarik tejkalohej qarkullimin prej tridhjetëmijë euro (30.000€), atëherë vetëm pjesa e furnizimit e cila rezulton në tejkalimin e qarkullimit, do të merret parasysh për qëllime të TVSH-së, gjë që në këtë rast e paditura duke marrë parasysh pragun e TVSH-së të cilin këtu paditësi e ka kaluar më 12/2016, atëherë me të drejtë vlerën prej 5,549.00 euro e ka trajtuar si vlerë të tatueshme për qëllime të TVSH-

së. Lidhur me këtë pikë është deklaruar edhe përfaqësuesi i autorizuar i këtu paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor e i cili ka theksuar se : *‘jam dakord që paditësi në momentin që e ka arritur pragun prej 30,000.00 €, i njëjti duhet të regjistrohet si deklarues i TVSH-së’*”.

Lidhur me pretendimin e paditësit se e hyra prej 5,278.86 euro e pranuar me datë 05.12.2016 nga jashtë pra nga partneri “A...” me seli në Gjermani është dashur që të trajtohet pa TVSH-ë, kjo bazuar edhe në sqarimin që është marrë nga Zyra për Informim e ATK-së sipas e-mailit të datës 23.12.2019, e nga i cili sqarim situata aktuale e paditësit është e sqaruar në tërësi, dhe referuar ligjit aktual të TVSH-së, për konstatimin e vendit të ofrimit të shërbimit, përderisa ofrimi i shërbimit nga këtu paditësi kryhet për kompaninë “A...” në Gjermani, dhe kompensimi kryhet përmes transaksioneve bankare, është e qartë që kompania duke i’u referuar edhe regjistrimeve të ARBK-së, nuk operon në Kosovë, për Gjykatën është i pa qëndrueshëm dhe i pa bazuar në ligj ngase këtë çështje e rregullon në mënyrë shprehimore dispozita e Udhëzimit Administrativ 03/2015, për zbatimin e ligjit 05/L-037 për TVSH-ë, respektivisht neni 25, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2.4., ku thuhet se *‘Në të kundërt, në çdo rast kur furnizuesi i shërbimit një person i tatueshëm i vendosur në Kosovë, nuk është në gjendje të vërtetojë si më sipër, pra të tregojë që vepron në kushtet e paragrafit 1 të nenit 20 të Ligjit, sipas së cilës furnizimi i shërbimit i është ofruar një personi të tatueshëm të identifikuar për TVSH-në jashtë Kosovës, atëherë vendi i furnizimit të shërbimit është në vendin e furnizuesit të shërbimit në Kosovë në përputhje me paragrafin 3 të nenit 20 të Ligjit’* .

Gjykata nga elaborimi i dispozitës ligjore të Udhëzimit Administrativ 03/2015, neni 25, par 2, nën par 2.2, ku decidivisht thuhet se : *‘Për përcaktimin e vendit të furnizimit të shërbimit, në vendin e pranuesit të shërbimit, furnizuesi është i detyruar të dëshmojë që shërbimi i është furnizuar një personi të tatueshëm që nuk është i vendosur në Kosovë, pra pranuesi i shërbimit është një person i tatueshëm për TVSH-në që vepron si i tillë jashtë Kosovës, referuar kuptimit të nocionit të personit të tatueshëm sipas dispozitave të nenit 20 të Ligjit. Në çdo rast kur pranuesi i shërbimit është një person i tatueshëm i TVSH-së jashtë Kosovës, atëherë, për të përcaktuar vendin e tatimit të furnizimit të shërbimeve, furnizuesi një person i tatueshëm i vendosur në Kosovë, duhet të marrë dhe*

disponojë informacionet e nevojshme nga pranuesi i shërbimit duke siguruar në një nivel të arsyeshëm verifikimin e këtyre informacioneve'', ka konstatuar se këtu paditësi as në procedurë administrative pranë të paditurës por as në shqyrtim gjyqësor pranë kësaj gjykate nuk ka bashkëngjitur dëshmitë e kërkuara me nenin 25, par 2, nën par 2.2.1. të Udhëzimit Administrativ si më lartë, dhe atë kontratën për shërbimin ku të identifikohet qartë emri i personit të tatueshëm, të dhënat e tij identifikuese, si dhe të identifikohet vendndodhja e qëndrueshme si marrës shërbimesh; dhe vërtetim nga autoritetet tatimore të vendit të pranuesit të shërbimit ku të shprehet qartë që personi i tatueshëm është i regjistruar për TVSH-në dhe numri i identifikimit të TVSH-së së personit të tatueshëm është aktiv, andaj në mungesë të këtyre dëshmive e paditura ka vepruar drejtë kur këtu paditësin për transaksionin e datës 05.12.2016 në shumën prej 5,278.86 euro e ka trajtuar si qarkullim për qëllime të TVSH-së për periudhën 12/2016.

Gjykata ka konstatuar se këtu paditësi të hyrën vendore prej 2,100.00 € e konsideron si vlerësim të drejtë nga e paditura ATK-ja, dhe të njëjtën nuk e konteston.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi, plotësim të padisë dhe në seancë sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 43, par 1. i LKA-së, "Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative", andaj paditësi në këtë konflikt administrative ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tij në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës

faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsytimit ligjor dhe faktik të padisë .

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi në pajtim me nenin 64, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, pasi që sipas këtij neni në konflikt administrativ secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.82/22 datë 10.10.2022

Bashkëpunëtori Profesional
Visar GASHI

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.